# DËSHMI ARKIVI

**A-454924**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Djali i Jakup Krasniqit: Nuk duhet të dorëzohemi, do na gjykojë historia |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392475.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 11:41:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 18 shtator 2026, 11:25:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 18 shtator 2026, 11:24:00 UTC → 18 shtator 2026, 11:26:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ed1dad1dc98d1878e32e44a9f8738283bad294b8c37cf07368bacaabf8d79708` |
| TEKSTI | `c7e634688bbfc7bd5115a0b66a959786193860bc0a2360c72f489e5016e37215` |
| PAMJA | `d4d6290ac019bf2c5dac764cb0c6a285f1191df8a2abb55d6ed22cc8a9db62cb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9afd0f0d4609c1cda674732016fc4adc1d4cd554c1eee1a534a1fdde78c40309` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9afd0f0d4609c1cda674732016fc4adc1d4cd554c1eee1a534a1fdde78c40309`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Djali i Jakup Krasniqit: Nuk duhet të dorëzohemi, do na gjykojë historia

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 18.09.2026, 13:25

Share Share



Altin Krasniqi, djali i ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka bërë thirrje për unitet dhe vijim të përpjekjeve për drejtësi pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj katër ish-drejtuesve të UÇK-së.

Duke iu drejtuar qytetarëve të mbledhur në protestë, Krasniqi tha se vendimi i Gjykatës nuk duhet parë vetëm si një çështje që prek katër persona, por si një zhvillim që, sipas tij, lidhet edhe me historinë dhe sakrificën e popullit të Kosovës.

Ai falënderoi qytetarët për mbështetjen ndaj familjeve të ish-drejtuesve të UÇK-së, ndërsa theksoi se lufta e UÇK-së, në këndvështrimin e tij, ishte një përpjekje për liri dhe dinjitet.

Krasniqi u shpreh se përballë situatës së krijuar nuk duhet të ketë dorëzim, duke theksuar se qëndrimet e shoqërisë ndaj kësaj çështjeje do të gjykohen edhe nga brezat e ardhshëm.

> "***Sot janë jo vetëm si biri i njeriut që po i bëhet padrejtësi, por si biri i këtij populli. Ajo që ndodhi në Hagë, prek sakrificën e çdo dëshmori, çdo veterani, çdo të zhdukuri familjet e të cilëve ende e kërkojnë. Sot nuk duhet të dorëzohemi sepse nëse ne dorëzohemi do të na gjykojë jo vetëm historia por edhe e ardhmja. Për 6 vjet kemi kërkuar drejtësi dhe do vazhdojmë të kërkojnë drejtësi. Sot i bëjmë thirrje edhe të gjithë partive politike të lëmë anash të gjitha dallimet dhe le të bëhemi bashkë", tha ai.***

Në fund të fjalës së tij, Altin Krasniqi iu drejtua shqiptarëve dhe partive politike me një apel për të lënë mënjanë përplasjet politike dhe për t'u bashkuar rreth kërkesës për drejtësi.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.